

## Gjykimi i këngëve me muzikë në këndvështrimin Islam

### Gjykimi i këngëve me muzikë në këndvështrimin Islam

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit Mëshirëbërësit

Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin e fundit, Muhamedin, salallahu alejhi ue selem.

Në kohët që po jetojmë, muslimanët e vendit tonë, po përballen me një sërë sfidash dhe problemesh. Në fakt, sa më shumë që largohemi nga koha e profetësisë, aq më e vështirë bëhet të kapurit pas fesë të cilën e ligjëroi Allahu dhe e zbatoi Profeti, salallahu alejhi ue selem, dhe shokët e tij.

Megjithëse përpara se të trajtojmë çështjen e muzikës dhe dispozitën e fesë islame për të, dua të vë theksin se shoqëria ku ne jetojmë, në përgjithësi është një shoqëri afetare, e cila muzikën e ka pjesë të jetës, gjë që e bën prezencën e saj një fenomen të paevitueshëm në shumë prej ambienteve tona. Ndaj, në këtë shkrim, nuk do të merrem as me trajtimin e rasteve dhe gjykimin e atyre të cilët e dëgjojnë muzikën për faktin se janë fillestarë apo me ata që e dinë se nuk duhet të dëgjojnë muzikë, por që për shkak të rrethanave dhe përbërjes që ka shoqëria shqiptare, marrin pjesë në evenimente apo gëzime të cilat shoqërohen me muzikë, për arsye që të mos humbin lidhjet farefisnore e të ndahen prej tyre.

Pra, ky shkrim është një përpjekje, për të orientuar muslimanët rreth dispozitës dhe gjykimit të muzikës, pasi ka kohë që grupe të caktuara, po përpiqen t'u mbushin mendjen se muzika nuk është e ndaluar dhe se kjo është veçse një mendim, duke u orvatur kështu që të gjejnë ndonjë thënie të çuditshme ndër brezat e kaluar apo ndonjë mendim që në fakt është shmangur nga argumentet, duke menduar kështu se do ta kenë më të lehtë t'u mbushin mendjen besimtarëve, se kjo është çështje ixhtihadije -përpjekja për të nxjerrë konkluzion fetar- dhe se njeriu mund të zgjedhë atë që i ngrohet zemra, e ku nuk lejohet të besosh se grupi tjetër është në gabim!

#### **Së pari: Kuptimi i këngës në aspektin etimologjik.**

Në mënyrë që tema të jetë sa më e qartë dhe të mos ngatërrohen termat -të cilat herë ndodhin si shkak i mosnjohjes, e herë qëllimisht-, kemi nevojë që pikë së pari të shpjegojmë termin *këngë* në aspektin etimologjik.

Kuptimi i termit *këngë* në etimologjinë arabe: ngritja e zërit, në mënyrë të vazhdueshme dhe të pa ndërprerë, tek arabët quhet: këngë.[1]

Arabët konsideronin si këngë, vjershat, por dhe recitimin që bënin ata që udhëhiqnin devetë në udhëtim. Imam Ibën Ethiri -Allahu e mëshiroftë- në librin e tij "en-Nihaje fi Garib el Hadith", ka shpjeguar hadithin e përcjellë nga Aishja -Allahu qoftë e kënaqur me të!- e cila ka thënë: "Kisha

dy vajza të vogla të cilat këndonin këngët e ditës së Buathit[2].[3]"Ato recitonin poezitë të cilat ishin thënë në ditën e Buathit dhe nuk ka për qëllim këngët që njihen në mesin e dëfryesve".[4]

Pra, arabët në kohën e Profetit, salallahu alejhi ue selem, por edhe më pas, këngë quanin zërat melodiozë me të cilat recitonin ose këndonin poezitë dhe që nuk shoqëroheshin me vegla muzikore.

Shejhul Islam, Ibën Tejmije -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Nëse bëhet e qartë një gjë e tillë, atëherë bëhet e ditur se: në tre brezat e artë, qofshin në Hixhaz, Sham, Jemen, Egjipt, Irak, Marok apo Khurasan, nuk ka patur asnjë prej dijetarëve, adhuruesve apo asketëve të atillë që të mblidheshin për të dëgjuar këngë në shoqërinë e veglave muzikore; një gjë e tillë ka ndodhur nga fundi i viteve dyqind dhe, kur dijetarët e hasën një gjë të tillë, e urryen dhe tërhoqën vëmendjen".[5]

Ndërsa në kohët e mëvonshme termi këngë përdorej për këngët pa vegla muzikore, por edhe për ato në të cilat përdorreshin veglat muzikore si: fyelli, mandolina, buzuku, defi -me xhingla-etj. Imam Ibën Haxher el Askalani -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Këngë quhen edhe muzika, edhe veglat muzikore".[6]

Ndoshta në kohët më të vona, veglat muzikore kanë hyrë në këtë term, për faktin se atyre u bien për të shoqëruar këngët. Kështu që, në këtë shkrim do të përqendrohemi më tepër rreth gjykimet të këngëve me muzikë, për faktin se për këngët pa muzikë, dhe që nuk kanë përmbajtje të keqe, shumica e dijetarëve janë për lejimin e tyre.

## **Së dyti: Argumentet nga Kurani rreth këngëve me muzikë**

Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin famëlartë: "**Ka disa njerëz që sajojnë tregime argëtuese, për të shmangur (të tjerët) nga rruga e Allahut me paditurinë e tyre e për t'u tallur me të. Njerëz të tillë i pret dënimi poshtërues**". Surja Lukman, 6.

Imam Ibën Kethiri -Allahu e mëshiroftë!- ka përcjellë nga Ebu Sahba el Bekri se ky kishte dëgjuar Abdullah bin Mes'udin -Allahu qoftë i kënaqur me të- i cili kur u pyet për këtë ajet tha: "Pasha Allahun, pos të cilit nuk ka zot tjetër të vërtetë, se ky ajet është për këngët (me muzikë) dhe këtë e përsëriti tre herë".[7]

Një mendim të tillë e kanë shprehur Ibnu Abasi, Xhabiri, Ikrima, Seid bin Xhubejr, Mekhuli, Mejmun bin Mehran, Amru bin Shuajb dhe Alij bin Bedhejme. Hasan El Basri ka thënë: "Ky ajet ka zbritur për muzikën dhe veglat muzikore".[8]

Po ashtu, Allahu i Madhëruar thotë: "Edhe ata që nuk dëshmojnë gënjeshtat e, kur kalojnë pranë kotësive, kalojnë me dinjitet". Sure El Furkan, 72.

Imam Ibën Kethiri -Allahu e mëshiroftë!-, përmend në komentin e këtij ajeti nga Muhamed bin Hanefije -Allahu e mëshiroftë!-, se këtu bëhet fjalë për këngët (me muzikë).[9]

Imam Kurtubiu dhe Taberiu -Allahu i mëshiroftë!- në tefsirët e tyre kanë përmendur nga Muxhahidi -Allahu qoftë i kënaqur me të!- të njëjtën gjë; pra, se gënjeshtat janë këngët (me muzikë).[10]

### **Së treti: Argumentet nga Suneti i Profetit, salallahu alejhi ue selem, rreth këngëve me muzikë**

1. Përcillet nga Ebu Malik el-Esh'ari -Allahu qoftë e kënaqur me të!-, se Profeti, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Do të dalin në umetin tim njerëz të cilët, do të lejojnë kurvërinë, mëndafshin, pijet alkolike dhe instrumentet muzikore..."[11]

Ndërsa tek Ibnu Maxhah përcillet nga Ebu Malik Esh'ari -Allahu qoftë e kënaqur me të!-, se Profeti, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Do të ketë prej umetit tim njerëz, të cilët do të pinë alkool dhe do ta quajnë me emra të tjerë; do të luhet mbi kokat e tyre me vegla muzikore e do t'u këndojnë femrat. Allahu këta do t'i fundosë në tokë dhe disa prej tyre do t'i kthejë në derra dhe majmunë".[12]

Këto hadithe argumentojnë qartë se muzika është e ndaluar, sepse Profeti, salallahu alejhi ue selem, shprehet qartë se ata do t'i konsiderojnë të lejuara pasi kanë qenë të ndaluara.

E dyta, sepse Profeti, salallahu alejhi ue selem, e bashkëngjiti muzikën bashkë me ndalesat e tjera si: mëndafshi, imoraliteti dhe alkooli.

2. Xhabiri -Allahu qoftë e kënaqur me të!-, përcjell se Profeti, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Unë nuk ju kam ndaluar të qani, por ju kam ndaluar (dy) zërat e të metëve dhe të shthururve: zërat që nxirren në mirëqenie gjatë dëfrimit dhe argëtimit, dhe rënia e fyejve të shejtanit (mjeteve muzikore), si dhe zërat gjatë fatkeqësisë: goditja e fytyrës dhe shkyerja e rrobave dhe meloditë e shejtanit (vajtimi me kujë)".[13].

Një hadith të ngjashëm me këtë përcjell dhe Enes Ibën Malik -Allahu qoftë e kënaqur me të!-, se Profeti, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Dy zëra janë të mallkuar në dynja dhe ahiret: këngët me muzikë në begati dhe vajtimi (me kujë) në fatkeqësi".[14].

Hadithin e Imam Buharit dhe Tirmidhiut, Imam Ibën Hazmi -Allahu e mëshiroftë!-, i ka konsideruar si jo të saktë, duke pretenduar se hadithi i Imam Buharit ka shkëputje, prandaj nuk shërben si argument. Por, Hafidh Ibën Haxher dhe plot dijetarë të tjerë-Allahu i mëshiroftë!-, kur e kanë komentuar këtë hadith, ka shpjeguar se hadithi është i saktë dhe se nuk ka asnjë shkëputje në të dhe se Imam Buhari -Allahu e mëshiroftë!-, e ka përmendur si argument dhe të sigurt edhe pse s'ka përmendur zinxhirin e tij, madje përtej kësaj e kanë kritikuar Ibën Hazmin për qëndrimin e tij.

Madje Imam Ibën Hazmi për hadithin te Tirmidhiu ka pohuar se ky është një hadith që s'ka

asnjë rrugë që e çon te Profeti, salallahu alejhi ue selem, edhe pse këto hadithe, siç e përmendëm, i kanë përcjellë dhe transmetuar një grup imamllarësh të cilët janë kolosë të fushës së hadithit. Madje ai është shprehur: "Rreth kësaj çështjeje nuk ka ardhur asnjë argument i saktë dhe çdo gjë e përmendur rreth saj është sajësë"[15] Ndërkohë përveç haditheve profetike ka plot fjalë të sahabëve dhe tabiinëve të ciët theksojnë që muzika është e ndaluar.

Prandaj dhe Hafidh Abdul Hadi -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë për Ibnu Hazmin: "Ai ka shumë iluzione kur flet rreth saktësimin dhe dobësimin të haditheve, të njëjtën gjë ka edhe kur flet për gjendjen e transmetuesve."

3. Nafiu -Allahu qoftë e kënaqur me të!-, përcjell se ai ishte një ditë me Ibnu Umerin -Allahu qoftë e kënaqur me të- dhe "Duke ecur Ibnu Umeri dëgjoi muzikë dhe i vendosi gishtat në vesh dhe u largua nga ajo rrugë, më pas pyeti:

-A dëgjohet më muzika?

-Jo, -iu përgjigja unë! Ai hoqi gishtat nga veshët dhe tha: "Isha një ditë me Profetin, salallahu alejhi ue selem, dhe ai dëgjoi muzikë dhe veproji kështu (i mbylli veshët)".[16]

Imam Kurtubiu -Allahu e mëshiroftë!-, kur flet për këtë hadith në tefsirin e tij thotë: "Dijetarët tanë kanë thënë: 'Nëse një gjë e tillë veprohej ndaj zërave të cilat nuk ishin shumë larg normales, ç'mund të thuash për këngët (me muzikë) dhe zërat e ditëve tona?!'[17]

Dijetarët kanë përmendur edhe hadithe të tjera, por për mostejzgatje po mjaftohemi me kaq.

### **Së katërti: Gjykimi i dijetarëve rreth muzikës**

Duhet thënë se ka një dakordësi të katër imamëve rreth asaj se veglat muzikore janë të gjitha të ndaluara.[18]

a- Ebu Hanife -Allahu e mëshiroftë!- dhe pasuesit e tij.

Imam Alusi -Allahu e mëshiroftë!-, ka deklaruar se muzika është e ndaluar; më pas ka përcjellë thënien e Imam Ebu Hanifes: "Muzika është e ndaluar në të gjitha fetë". Ndërsa Serrakhsi -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Nuk pranohet dëshmia e atij që dëgjon muzikë".[19]

b- Imam Maliku -Allahu e mëshiroftë!- dhe pasuesit e tij.

E pyetën Imam Malikun -Allahu e mëshiroftë!- se çfarë muzike lejojnë banorët e Medinës, ai tha: "Këtu tek ne, me muzikë nuk merren vetëm se të prishurit".[20]

Një herë Ibën Kasim -Allahu e mëshiroftë!- e pyeti mësuesin e tij Imam Malikun rreth muzikës dhe ai u përgjigj: -Allahu thotë në Kuran: "E çfarë ka pas së vërtetës, përveç humbjes?" Surja Junus, 32. A mos është e vërtetë ajo?[21]

Kasim bin Muhamed -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Muzika është humbje, ndërsa humbja është në zjarr." [22]

Ndërsa Imam Axhurri -Allahu e mëshiroftë!- ka përcjellë nga Imam Taberiu –Allahu e mëshiroftë!- se ka pohuar: "Imam Maliku e ka ndaluar muzikën dhe dëgjimin e saj." [23]

Imam Euzai -Allahu e mëshiroftë!- thoshte: "Lejimi i muzikës te banorët e Medinës ka qenë nga shkarjet e dijetarëve, e cila sot e kësaj dite vazhdohet të ndalohej." [24]

c- Imam Shafiu -Allahu e mëshiroftë!- dhe pasuesit e tij.

Imam Shafiu ka thënë në librin e tij El Um: "Muzika është e urreyer dhe i përngjan humbjes, e kush e tepron në dëgjimin e saj, konsiderohet i mangët dhe i refuzohet dëshmia". [25]

Imam Ibën Kajim -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Nxënësit e Shafiut, të cilët e njohin medhhebin e tij, kanë pohuar se muzika është e ndaluar dhe kanë kundërshtuar faktin se ai e ka lejuar atë. Këtë e ka pohuar kadiu Ebu Tajib Taberi, Ebu Ishak dhe Ibnu Sabbag". [26] Madje, është e njohur shprehja e tij (Shafiut): "Kam lënë në Irak diçka të cilën e quanin tegbijr [27] vepër që e shpikën zenadikat [28], me të cilën largojnë njerëzit nga Kurani." [29]

d- Imam Ahmedi -Allahu e mëshiroftë!- dhe pasuesit e tij.

Abdullah bin Ahmed bin Hanbel -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "E pyeta babanë rreth muzikës? Ai tha: "Muzika mbjell hipokrizinë në zemër." [30]

Po ashtu, Abdullahu ka përcjellë se ka dëgjuar babanë e tij Ahmed bin Hanbelin të thotë: "Kam dëgjuar Jahja bin Kattanin -Allahu e mëshiroftë!- të thotë se nëse dikush vepron me lehtësimet që thonë banorët e Kufes rreth Nebidhit [31], lehtësimin e banorëve të Medinës rreth muzikës dhe lehtësimet e banorëve të Mekës rreth Mut'as (martesës me kontratë) [32], ai padyshim është prej të prishurve." [33]

Thënie të dijetarëve të tjerë

Ibën Ebi Dun'ja dhe Bejhakiu -Allahu i mëshiroftë!- kanë përcjellë se Sha'biu -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "I mallkuar është kënduesi (me muzikë) dhe ai të cilit i këndohet." [34]

Fudejl bin Ijadi -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Muzika është ftesë për në zina (imoralitet)". [35]

Ndërsa Umer bin Abdulazizi -Allahu e mëshiroftë!- porosiste mësuesin e djalit të tij: "Le të jetë gjëja e parë që të fitojë nga edukata jote, urrejtja e muzikës, fillimi i së cilës është nga shejtani,

ndërsa fundi i saj është zemërimi i Allahut..."[36]

Këtu duhet të pohojmë se disa dijetarë kanë pohuar konsensusin dhe Ixhmanë (unanimitetin) e dijetarëve se muzika është e ndaluar.

Ebu Umer bin Salah -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Dijeni se defi nëse bashkohet me fyellin, dëgjimi i tyre është i ndaluar tek të gjithë dijetarët e medhhebeve, por edhe te dijetarët e tjerë, madje nuk është pohuar nga asnjë prej dijetarëve të cilëve u merret thënia në Ixhma që të ketë lejuar këngët (me muzikë)". [37]

Imam Ibën Haxher el Hejtemi -Allahu e mëshiroftë!- ka pohuar se ka Ixhma rreth ndalimit të përdorimit të mjeteve muzikore, më pas tha: "Ata të cilët kanë thënë se rreth kësaj çështje ka më shumë se një mendim, kanë gabuar ose ka sunduar mbi ta egoja e cila i ka verbuar dhe shurdhuar".[38]

Prej dijetarëve që kanë pohuar se ka Ixhma rreth ndalimit të muzikës është dhe imam Ebu Bekër Axhurri -Allahu e mëshiroftë!-.[39]

Imam Bagaviu -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Dijetarët kanë rënë në konsensus rreth ndalueshmërisë (haramit) së fyellit dhe instrumenteve të tjera të dëfrimit dhe rreth ndalueshmërisë nuk ka asnjë mosmarrëveshje". [40]

Imam Ebu Abas Kurtubi -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Këngët me muzikë janë të ndaluara në Kuran dhe hadith", më pas shtoi: "Sa i përket fyellit, telave dhe daulles, nuk ka kundërshtim rreth ndalueshmërisë së saj, madje nuk kam dëgjuar asnjë prej selefëve dhe ndjekësve të tyre që ta lejojë një gjë të tillë...".[41]

Ndërsa Muafak Ibën Kudame -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Instrumentet e dëfrimit si: buzuku dhe fyelli, janë instrumente të ndaluara me Ixhma".[42]

Imam Neveviu -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Fyelli irakian dhe rënia e telave (lahutë, mandolinë, buzuk), janë të ndaluar në mënyrë të pakontestueshme".[43]

Dijetarë të tjerë që kanë përmendur konsensusin dhe unanimitetin rreth ndalueshmërisë së muzikës dhe instrumenteve muzikore janë dhe: Shejhul Islam Ibën Tejmije[44], Ibën Kajim el Xheuzije[45] dhe Imam Bezazi nga dijetarët Hanefi[46].

Dijetarët të cilët kanë pohuar se muzika normale lejohet dhe çfarë i ka shtyrë ata të marrin këtë vendim dhe si është komentuar qëndrimi i tyre?

Edhe pse përmendëm një sërë argumentesh dhe thënie të dijetarëve rreth ndalueshmërisë së muzikës dhe instrumenteve muzikore, sërish një numër i vogël dijetarësh, kanë pohuar se muzika lejohet dhe këtë e kanë bazuar në disa shkaqe.

Nga dijetarët që është njohur për lejimin e muzikës dhe instrumenteve muzikore është Imam Ibën Hazmi i cili -sikur përmendur dhe më lart- e ka konsideruar të dobët hadithin e përmendur tek imam Buhari, po ashtu edhe hadithet e tjera rreth kësaj teme, duke u shprehur se nuk ka asnjë hadith të vërtetë rreth kësaj!

Imam Ibën Hazmin në këtë mendim e ka pasuar dhe Imam Muhamed bin Tahir Shejbani, i njohur si Ibën el Kajserani, Ebu Hamid el Gazali, po ashtu edhe Imam Ebu Bekër ibën El Arabi (maliki) në tefsirin e tij, Imam Sheukani në "Nejl Eutar". Ndërsa nga bashkëkohorët: Shejh Muhamed el Gazali dhe shejh Jusuf Kardavi në librin "Hallalli dhe harami".

Duke pohuar se nuk ka argumente të vërteta rreth muzikës, këta dijetarë janë kapur pas origjinës; pra, se muzika është hallall në origjinë dhe përderisa nuk ka argumente të sakta për ndalimin e saj ajo mbetet e tillë.

Këta dijetarë, janë përpjekur po ashtu të sjellin edhe transmetime se disa sahabë kanë dëgjuar muzikë, por që për fat të keq, nuk kanë përmendur asnjë transmetim me zinxhir të saktë rreth pohimeve të tyre.

Në lidhje me dobësimin që Imam Ibën Hazmi i bën hadithit tek Imam Buhari: "Do të dalin në umetin tim njerëz të cilët, do të lejojnë kurvërinë, mëndafshin, verën dhe instrumentet muzikore...", me pretendimin se në të ka shkëputje dhe se Imam Buhari, nuk e ka dëgjuar këtë hadith nga Hisham bin Amar, dijetarët janë shprehur si më poshtë:

Hafidh El Iraki -Allahu e mëshiroftë!-ka thënë: "Hisham bin Amar është nga mësuesit e Buhariut, fjalët e të cilit i ka përmendur si argument në librin e tij të saktë."

Ndërsa Hafidh Ebu Amru bin Salah -Allahu e mëshiroftë!- ka thënë: "Ebu Hazmit nuk i merret parasysh refuzimi që i ka bërë hadithit të Imam Buharit".[47]

Vargut të dijetarëve të cilët kanë kundërshtuar gjykimin e Ibnu Hazmit i është shtuar edhe Ibën Kajimi i cili ka thënë: "Përfolja që i ka bërë Ibnu Hazmi hadithit të Buharit, nuk ka mundur ta ndihmojë mendimin e tij të kotë rreth lejimit të muzikës..."[48] Madje, këtë hadith, e kanë përmendur me zinxhir të plotë dhe të saktë një numër i madh i dijetarëve të hadithit, prej tyre: Taberani në "Musned Shamijin"[49], Ibën Hibani në "Sahihun" e tij[50], Ebu Neim në "Mustekhreh ala Sahih el Bejhaki"[51], Ibën Asakir në "Tarrikh"[52], El Hasen bin Sufjan në "Musnedin" e tij[53], etj.

## **Shkaku i dytë që i ka shtyrë këta dijetarë të mendojnë se muzika është e lejuar**

Një shkak tjetër është hadithi të cilin e përcjell Aishja e cila thotë: "Profeti hyri në shtëpi teksa unë kisha dy vajza të vogla të cilat po këndonin këngët e ditës së Buathit. Profeti u shtri në krevat dhe ktheu fytyrën, ndërkohë në shtëpi hyri Ebu Bekri i cili, kur i pa duke kënduar, më qortoi dhe më tha: -Melodia e shejtanit në shtëpinë e Profetit! Profeti u kthye nga ai dhe i tha: -Lëri ato!"[54]

Ky hadith është përcjellë në rrugë dhe forma të ndryshme transmetimi, megjithatë dijetarët kanë thënë se Aishja ka pohuar se ato ishin dy vogëlushe të cilat po këndonin këngë të ditës së Buathit, të cilat ishin poezi dhe balada lufte dhe trimërie. Nëse ky hadith do të bënte fjalë për muzikën që kanë për qëllim lejuesit, si ka mundësi që vëllai i Aishes, Muhamed bin Ebu Bekër që është nxënës i saj dhe babai i një ndër shtatë fukahave të Medinës të thotë: "Muzika është humbje dhe humbja është në zjarr"?![55]

Një shkak tjetër që i ka çuar në këtë mendim lejuesit e muzikës, si Ibën Hazmi dhe ata që e kanë pasuar si: Sheukani etj, është se kanë përcjellë disa ngjarje të disa sahabëve që sipas tyre tregojnë për lejimin e muzikës.

Në fakt, është e habitshëm fakti se këta dijetarë, që kanë bërë gjithë atë përpjekje të stërmundimtë, të konsiderojnë të dobët dhe të papranueshëm hadithet e qarta që tregojnë ndalimin e muzikës, ndër to dhe hadithim të *Sahih Buhari*, ndërkohë që nuk marrin as mundimin më të vogël për të faktuar këto transmetime mekufë[56] të cilat i përcjellin nga sahabët!

Shejh Albani -Allahu e mëshiroftë!- në lidhje me përmendjen e këtyre transmetimeve ka thënë: "Sheukani është zgjeruar goxha në këto transmetime, por pa dobi, sepse shumica e tyre janë transmetime, hadithe të varura (mualak)[57], të cilat nuk kanë as fre, as rrip kapistre; madje disa prej tyre është transmetuar se kanë pohuar të kundërtën, ndërsa disa të tjera janë me tekst të dyshimtë"[58].

Ndërsa Shejh Feuzani në librin kritik që ka bërë ndaj librit "Hallalli dhe harami në Islam" të dijetarit Jusuf Kardavi, ka thënë: "Në fakt kjo është një pretendim, ndaj dhe ne i kërkojmë doktor Kardavit që të bëjë publike zinxhirin e saktë të këtyre transmetimeve."

## **Së pesti: Këngët që lejohen në Islam**

Islami si një fe e zemërgjerësisë dhe lehtësimit, e zbritur nga Allahu i Gjithdituri dhe plot urtësi, i Cili e njeh realitetin e qenies njerëzore dhe çfarë është në dobi të tij, u ndaloi besimtarëve këngët me instrumente muzikore, të cilat në përgjithësi janë simbol i shthurjes që ftojnë në të, porse u ka lejuar atyre këngët dhe argëtimin e pranuar në disa raste. Disa prej tyre janë:

1. Në ditët e festave -dy Bajrameve-: Muslimanëve u është lejuar që të festojnë në ditët e Bajramit, të shfaqin harenë dhe të argëtohen ata dhe fëmijët e tyre, ndaj dhe lejohet që në këto ditë fëmijët të recitojnë dhe këndojnë, qoftë kjo e shoqëruar edhe me def (pa xhinga).

Përcillet nga Aishja se Ebu Bekri hyri në çadrën e saj dhe të Profetit dhe gjeti atje dy vajza të vogla të cilat po këndonin dhe i binin dajres, ndërkohë që Profeti ishte shtrirë, i mbuluar me rrobën e tij. Ebu Bekri kur i pa u bërtiti, por Profeti, salallahu alejhi ue selem, zbuloi kokën dhe tha: "Lëri o Ebu Bekër, sepse këto janë ditë feste", dhe kjo ishte në ditët e Minasë.[59]

2. Gjatë ceremonisë së dasmës: Dita e dasmës është një ditë e shënuar për njeriun, ndaj



dhe Islami ka lejuar që në këtë ditë të ketë gëzim dhe hare.

Përcillet nga Rrabij bint Afra -Allahu qoftë e kënaqur me të!- se ka thënë: Profeti, salallahu alejhi ue selem, erdhi tek ne në ditën e dasmës sime, ndërkohë që vajzat e vogla po këndonin për të rënët në Bedër dhe i binin deficit (pa xhingla)...[60]

Ndërsa Muhamed bin Hatib ka përcjellë se Profeti, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Dallimi mes martesës së lejuar dhe asaj të ndaluar[61], është rënia e deficit dhe bëria publike e nikahut (martesës)". [62]

### 3. Kur dikush kthehet nga udhëtimi pas një kohe të gjatë:

Burejde ka thënë se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, shkoi në një ekspeditë luftarake, kur u kthye nga ekspedita, i doli përpara një vajzë e vogël (me ngjyrë) dhe i tha: -O i Dërguar i Allahut! Unë u betova se nëse Allahu do të të kthente shëndoshë e mirë, do të këndoja para teje dhe do t'i bija deficit. Profeti i tha: "Nëse je betuar, atëherë bëje, por nëse nuk je betuar, atëherë më mirë lëre"...[63]

## **Së gjashti: Përse muzika është e ndaluar në Islam?**

Në fakt, nëse do të shohësh me kujdes se çfarë gjurmësh lë muzika te njeriu, do ta kuptosh fare mirë se përse feja Islame e ka ndaluar muzikën. Megjithatë në mbyllje të këtij shkrimi, le të përmendim disa nga këto shkaqe.

a). Muzika e sëmur dhe e dobëson zemrën: Zemra, ky organ i habitshëm, nuk ka si funksion vetëm pompimin dhe qarkullimin e gjakut, porse është mbretëresha e të gjitha gjymtyrëve, sepse ajo është vatra e ndjenjave si dashuria, dhembshuria, gezimi dhe hidhërimi. Aty është vendi ku gjenden cilësitë e mira të besimitarit si; besimi, frika, shpresa, nënshtrimi, përlulja, mbështetja, krenaria, dashuria, etj. Nëse kjo zemër do të ushqehet vetëm me muzikë, ajo padyshim që nuk do ti shërbejë rritjes apo kultivimit të besimit, nuk i shërben as nënshtrimit të Allahut dhe dashurisë së Tij. Këto gjëra nuk janë natyrë e muzikës dhe muzika nuk është ushqim për to, ndaj dhe zemra sëmurët –në aspektin figurativ- dhe dobësohet, besimi pak e nga pak vyshket, e drita e tij sa vjen dhe dobësohet, ndërsa Profeti salallahu alejhi ue selem ka thënë: "Në trup gjendet një organ; nëse ai rregullohet, atëherë i gjithë trupi rregullohet bashkë me të, por nëse ai priset, bashkë me të priset dhe trupi. Ajo është zemra".[64]

b). Muzika e huton mendjen dhe çrregullon ndjesitë e zemrës duke larguar ndjesitë shpirtërore dhe e bën të largohet nga Kurani: Është e vështirë të gjesh dikënd që është i dhënë pas muzikës, dhe ndërkohë të ketë një miqësi të ngushtë dhe të pa ndashme me Kuranin. Kjo për faktin sepse muzika në përgjithësi fton në argëtim dhe dhënie pas kënaqësive të kësaj bote

–pasuri, femra, pushtet, etj.- ndërsa Kurani, fton për në kënaqësinë e Allahut dhe lumturinë e Botës së Përtejme.

c). Muzika fton për në shthurje: Nëse do të shohim në realitetin që jetojmë, është shumë e vështirë të gjesh ndonjë muzikant, apo këngëtar që nuk është i shthurur, me përjashtim të atyre që Allahu u ka hapur zemrën dhe i ka udhëzuar, kjo sepse këngët dhe muzika nga natyra e tyre, janë mjete që të çojnë dhe orientojnë drejt joshës dhe argëtimit, të cilat përfundojnë me shthurje.

**Përfundim:** Pa dyshim që kjo është një përpjekje modeste, e cila sikurse dhe e sqaruar ka si qëllim sqarimin e muslimanëve rreth një fenomeni i cili po përpiqet të futet edhe në shoqërimin e adhurimeve si pjesë e fesë[65], ndërkohë që argumentet fetare dhe qëndrimet e dijetarëve janë në kundërshtim të plotë me konsiderimin e muzikës si hallall.

Allahut i kërkoj falje, nëse në këtë shkrim ka ndonjë shkelje apo diçka të pasaktë, duke pranuar se kjo është një përpjekje modeste dhe gabimi është pjesë njerëzore.

Përgatiti: Hoxhë Bledar Haxhiu

---

#### Referencat

[1] "Lisanul Arab", 15/136,139.

[2] Buathi; është emri i një lufte e cila ka ndodhur mes ensarëve, banorëve të Medines.

[3] Buhari, 949 dhe Muslimi, 892.

[4] "Nihaje fi Garib el Hadith", 3/392.

[5] "Mexhmuatul fetava", 11/569.

[6] "Fethul Bari", 10/55.

[7] "Tefsir Kurani Adhim", 6/330.

[8] Po aty: 6/331; "Xhamiul Ahkamil Kuran", Kurtubi, 14/52.

[9] "Tefsir Kurani Adhim", 6/130.

[10] "Xhamiul Bejan", 19/313 dhe "Xhamiu Ahkamil Kuran", 13/80.

[11] Transmeton Buhariu, 5590.

[12] "Sunen Ibnu Maxha", 4020, e ka saktësuar Albani.

[13] "Sunen Tirmidhi", 1005, i cili e ka konsideruar si hadith hasen; "Mustedrek ala Sahihejn", Hakim, 4/43; "Sunenul Kubra", Bejhaki, 4/69; "Musned Tajalisi", 1683; "Sherh Meani", Tahavi: 4/29. Shejh Albani e ka konsideruar të mirë në "Sahih el Xhami", 5924.

[14] "Ahadith el Mukhtara", el Makdisi, 6/189; "Musned el Bezarr", 14/62. Shejh Albani e ka konsideruar të mirë në "Sahih el Xhami", 3801.

[15] "El Muhala", 9/55-59.

[16] "Sunen Ebi Daud": 4926; "Sunen el Kubra", Bejhaki, 21526. Shejh Albani e ka vlerësuar hadithin të saktë.

[17] "Xhamiu Ahkamil Kuran", 10/290.

[18] "Mexhmuatu el Fetava", Ibën Tejmije, 11/567; "Silsiletu Ahadith Es Sahiha", 1/140.

[19] "El Mabsut", 16/132; "Hashijetul Xhemel", 5/380; "Hashijetu Ibën Abidin", 4/384, 5/253; "Hashitu Desuki", 4/166; "El Mugni", 9/175; "Umdetul Karrij", 6/271; "Bedaiu Senai", 6/269, 297; "Esna el Metalib", 4/344.

[20] "Telbis Iblis", Ibën Xheuzi, 244.

[21] "Mad'hal Ibnul Haxh" 3/118.

[22] Po aty: 3/118.

[23] "Tahrim Nerdi, ue Shetranxh, uel Melahi", 161.

[24] "Resailu Ibnu Rexheb", 2/459.

[25] "El Um", 6/214-215.

[26] "Ahkam el Gina", Ibën Kajim, 6.

[27] Tegbijr; vjen me kuptimin melodi e cila vjen si pasojë e recitimit të vjershave e shoqëruar me rënien në lëkurë të thatë me dorë apo shkop. E ka marrë këtë emër nga gubari -dheu/pluhuri- dhe kjo sepse këto lëkura kanë qenë të pluhurosura. Ndërsa në një kuptim tjetër ka ardhur si: dhikri i cili bëhet me zë të lartë dhe melodi të ndryshme i cili kishte si synim nxitjen e njerëzve rreth saj.

[28] Zenadika; është shumësi i fjalës *zendik* që vjen me kuptimet: jomusliman, i prishur, i devijuar dhe hipokrit.

[29] "Emër bil Maruf ue Nehju anil Munker", Khalal, 36; "Hiljetul Uelija", Ebu Neim, 9/164; "Telbis Iblis", Ibën Xheuzi, 244.

[30] "Mesail Ahmed", 316.

[31] Bëhet fjalë për një lloj pije alkoolike për të cilën pretendonin se është e lejuar ndryshe nga pijet e tjera alkoolike në ndaluara.

[32] Mut'atu; është një lloj martesë (martesë me kontratë), të cilën Islami e ndaloi.

[33] "El Musvedetu", Ibën Tejmije, 518.

[34] "Shuabul Iman", 4751.

[35] "Igathetu Lehfan", Ibnul Kajim, 1/499.

[36] "Gadhaul Elbab", Sefarini.

[37] "Igathetu Lehfan", Ibnul Kajim, 350.

[38] "Kefu Rria'u", 118.

[39] "Tahrim Nerdi ue Shetranxh uel Melahi", 39.

[40] "Sherh Sune", 12/383.

[41] "Ez Zevaxhir", Ibën Haxher el Hejtemi, 3/258.

[42] "El Mugni", 9/115.

[43] "Rreudatu Talibin", 8/205.

[44] "Mexhmuatul fetava", 28/118.

[45] "Medarixhu Salikin", 1/491.

[46] "Bahru Rraik", 7/89.

[47] "Mukadimetu ibni Salah", 67.

[48] "Igathetu Lehfan", 1/259; [49] 1/334, 588; [50] 8/265, 6719; [51] 10/221; [52] 19/79.

[53] "Huda Sarij", 50.

[54] Buhari dhe Muslimi.

[55] "Tefsir Kurtubi", 14/52.

[56] Meukuf; në shkencën e hadithit, është çdo transmetim i cili shkon deri te sahabi, e që nuk mund të ngrihet deri te Profeti, salallahu alejhi ue selem, dhe i cili mund të jetë i saktë, i dobët apo i sajuar.

[57] Mualak; janë hadithet apo trasmetimet të cilat nuk kanë zinxhir dhe në përgjithësi përmendet vetëm sahabi.

[58] "Tahrim alatu Tarab", 98.

[59] Buhari, 944 dhe Muslimi, 892.

[60] Buhariu, 4852.

[61] Këtu ka për qëllim dallimin mes martesës dhe lidhjeve jo me kurorë.

[62] Tirmidhiu, Ibnu Maxha dhe Nesai. Shejh Albani e ka konsideruar hadithin të saktë.

[63] Tirmidhiu, 3690. Shejh Albani e ka konsideruar hadithin të saktë.

[64] Buhari dhe Muslimi.

[65] Rreth kësaj mund të lexohet edhe materiali "THËNIE RRETH HADRAS SUFISTE" në portalin [www.burimijetes.com](http://www.burimijetes.com) në linkun: <http://burimijetes.info/2017/index.php/doctrine/knowledg-e-about-faith/134-thenie-rreth-hadras-sufist>